

-- Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Viti, sipas gjyqtarit Xhavit Haziri dhe sekretarja Juridike Naime Ibishi, duke vendosur në procedurën kundërvajtse kundër të pandehurit Xhevat Bislimi nga Vërbani, për shkak të kundërvajtjes sipas nenit 17 paragrafi 1 e sanksionuar sipas dispozitave të nenit 17 paragrafi 1.1. të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarve të lart publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar Nr. 04/L-050, e në pajtim të nenit 73, 195, të Ligjit mbi kundërvajtjet me datën 25.09.2012 shpall këtë:

AKTVENDIM

I pandehuri Xhevat Bislimi i lindur me 22.07.1961, në Vërbani, i martuar, babë i 4 fëmijëve, ka të kryer fakultetin, me profesion këshilltar i asamblesë komunale, me gjendje të mesme ekonomike, gje më tani i pa denuar shqiptar, shtetas i Republikës Kosovës.

ËSHTË PËRGJEGJËS

Sepse duke qenë në pozitën e këshilltarit të asamblesë komunale të KK. Vitisë, nuk ka përmbush obligimin ligjor që parashihet me Ligj për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të zyrtarve të lart publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, edhe pse këtë deklarim ka qenë i detyruar ta bëjë brenda afatit të caktuar ligjor prej 01.03.2012 gjer më 31.03.2012.

Me çka ka kryer kundërvajtje sipas nenit 17 paragrafi 1 e sanksionuar sipas dispozitave të nenit 17 paragrafi 1.1. të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarve të lart publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar Nr. 04/L-050

DËNOHET

ME DËNIM GJOBE në shumë prej 1.000 Euro, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, në të kundërtën i njëjti do t'i zëvendësohet në dënim burgu në kohëzgjatje prej 30 ditësh, konform nenit 5 të LMK-së.

Obligohet i pandehuri që kësaj Gjykate t'i paguaj paushallin në shumë prej 5 €, konform nenit 109 paragrafi 6 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

A r s y e t i m

Agjencia kundër korrupsionit në Prishtinë ka bërë kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse nr. 01-2514/12 të datës 24.07.2012, ndaj të pandehurit Xhevat Bislimi për shkak të kundërvajtjes sipas nenit 17 paragrafi 1 e sanksionuar sipas dispozitave të nenit 17 paragrafi 1.1. të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarve të lart publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar Nr. 04/L-050

Gjykata ftoi dhe morri në pyetje të pandehurin i cili në séancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datën 05.09.2012 deklaroi: Fare nuk ishte njoftuar aspak nga zyra e personelit të komunës lidhur me dërgimin e të dhënave pranë Agjencionit kundër korrupsionit dhe as që kishte nënshkruar personalisht marrjen e formularve nga ky agjencion. Prandja, për këtë lëshim fajson zyren e personelit të komunës ku përgjegjës ishte Agim Sylejmani sepse dërgimin e të dhënave do ta bënte pa kurrfar vonese sepse ai edhe më parë kur ishte kandidu si deputet dhe këshilltar komunal në aftin ligjor kishte dorzuar të dhënat pran organit kompetentë.

Meqenëse i pandehuri ishte njoftuar nga ana e gjykatës me kërkesën e këtij agjencioni ai pa vonesë kishte paraqitur të dhënat në këtë agjenci ku si provë materijale në gjykatë sjellë vërttimin nr.03-3683 të datës 04.09.2012 ku kishte dorzuar të dhënat për deklarimin, prejardhjen e pasurisë në agjencionin antikorrupsion në Prishtinë.

Dëshmitari Agim Sylejmani mes tjerash deklaroi si person zyrtar përgjegjës për shërbuesit civil është zyrtar i personelit Besim Lubishtani, ndërsa për këshilltar të asamblesë komunale, shërbimi profesional i kuvendit përkatës është zyrtari Shaban Fetahu.

REPUBLICA KOSOVA	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
Emri	Ag. Prok.
Adresa	S. Prok.
Posta	Posta No.
Nr. Eftan	Emri
Gjykatë	Datën
Nr. Protokolli	Date
PRISHTINE	

DPK/DMP 03-3865/12 02 25-10-2012

03-3865/12/02
slug

Sipas deklaratës të dëshmitarve Besim Lubishtani zyrtar i personelit dhe Shaban Feahu Sekretar i kuvendit komunal në Viti ata mes tjerash deklarojnë: Pas pranimi të kërkesës nga ana e Agjencionit kundër korrupsionit që të dy së bashku kishin hartuar listen me emra të zyrtarve të lartë dhe këshilltarve, ku me ndihmën e shpërndarsit të postës pran KK. Viti të gjithë zyrtarve dhe këshilltarve të asamblesë ju ishin dorzuar personalisht formulari për deklarimin e pasurisë e në mesin e tyre edhe Xhevat Bislimit e që shifet se me datën 12.03.2012 e kishte nënshkruar dhe pranuar formularin.

Mirpo me kohë i njeiti këtë formular nuk e kishte dorzuar te Sekretari i kuvendit ashtu që formularët e plotësuar nga ana e zyrtarve të lartë dhe këshilltarve komunal në afatin e caktuar ligjor t'ia dorzojnë Agjencisë kundër korrupsionit në Prishtinë.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, gjykta morri në pyetje dëshmitarin Sami Halili i cili mes tjerash deklaroi: Pas marrjes së listës nga ana e Sekretarit të kuvendit komunal lidhur me dorzimin e formularve nga ana e Agjencisë kundër korrupsionit për zyrtar të lartë dhe këshilltar komunal kishte bërë shpërndarjen e këtyre formularve ashtu që me datën 12.03.2012 dhe personalisht kishte shkuar në shtëpinë e Xhevat Bislimit në fshatin Vërban, ku marrjen e formularit e kishte nënshkruar babai i Xhevatit, Ismajl Bislimi.


Gjykta pas marrjes së kërkesës nga ana e organit kompetetë, vlersoi thënjet në kërkesën e parashtruar, deklarimin e të pandehurit në seanceën e shqyrtimit kryesor, deklaratatë të dëshmitarve dhe provave të tjera materijale sidomos lista me emra dhe mbiemra si dhe nënshkrimi i zyrtarve të lartë dhe këshilltarve komunal për pranimin e formularve të hartuar nga zyra e personelit të datës 21.02.2012 për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë, konstatoi se tek i pandehuri ekzistojnë elementet e kundërvajtjes të paraparë sipas dispozitave të nenit 17 paragrafi 1 e sanksionuar sipas dispozitave të nenit 17 paragrafi 1.1. të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar Nr. 04/L-050.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata si rrethanë rënduese pati parasysh peshën e kundërvajtjes së bërë rrethanat në të cilat është bërë kundërvajtja, shkallën e përgjegjësisë, si dhe rrethanat personale të pandehurit. Ndërsa si rrethanë letsuese gjykata pati parasysh gjendjen ekonomike të pandehurit pastaj vërtetimin mbi deklarimin, prejardhjen e pasurisë dorzuar në Agjencinë kundër korrupsionit në Prishtinë nr.03-3683/12 të datës 04.09.2012 me çka e shpalli fajtor të pandehurin, duke ia shqiptuar dënimin me gjobë në lartësi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË VITI.

Regj.Nr.3448/2012
Me. 25.09.2012

Sekretarja juridike
Naime Ibishi



UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 8 ditësh pas marrjes së aktvendimit. Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.